



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

**THIRRJE PUBLIKE PËR PROJEKTET NË FUSHËN KULTURËS, RINISË DHE
SPORTIT PËR OJQ PËR VITIN 2025**

Udhëzimet për aplikantët

Data e hapjes së thirrjes: 06.03.2025

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 15 ditë pune nga data e publikimit të thirrjes
publike dhe përfundon më datën: 26.03.2023**

Përmbajtja

1. THIRRJE PUBLIKE PËR PROJEKTET NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT PËR OJQ PËR VITIN 2023.....	3
1.1 Fushat e përkrahjes së projekteve	3
1.2 Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve.....	4
1.3 Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes.....	5
2. Kushtet formale të thirrjes.....	5
2.1 Kush mund të aplikoj?.....	5
2.2. Shpenzimet e të pranueshme që do të pranohen përmes kësaj thirrje.....	5
3. SI TË APLIKONI?	5
3.1 Forma e përshkruese e projekt propozimit.....	6
3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit.....	6
3.3 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?.....	7
4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE.....	7
4.1 Procedurat nëpër të cilat kalojnë aplikacionet.....	7
5. KALENDARI I REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE.....	8
6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE.....	8

1. THIRRJE PUBLIKE PËR PROJEKTET NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT PËR OJQ PËR VITIN 2025

1.1 Fushat e përkrahjes së projekteve:

Problemet të cilat synohen të adresohen me këtë thirrje publike janë përkrahja financiare të projekteve:

Kultura:

- Teatër;
- Muzikë;
- Arte vizuale;
- Diversitet kulturor dhe dialog;
- Aktivitete letrare;
- Botime.

Rinia:

- arsim;
- punësim;
- shëndet publik;
- çështje sociale;
- kulturë, sport dhe rekreacion;
- edukim qytetar dhe demokraci;
- ambient, planifikim hapësinor dhe zhvillim rural

Sporti:

- Aktivitet sportive;
- Pjesëmarrja e klubeve sportive në gara kampionale dhe për kupën e Republikës të organizuar nga Federatat përkatëse;
- Pjesëmarrja nëpër turne të ndryshme në vend dhe regjion;
- Organizimi i Turneve me rastin e festive shtetërore dhe kombëtare;
- Organizimi i turneve me rastin e shënimit të datave përkujtimore.

1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivat e përgjithshme:

- Ngritja e kapaciteteve në fushën e sportit;
 - Organizime promovuese dhe profesionale sportive;
 - Promovuese, të cilat kanë për qëllim paraqitjen dhe integrimin e sportistëve vendor në skenën vendore dhe ndërkombëtare;
 - Stimuluese, të cilat kanë për qëllim evidentimin e talentëve të rinjë me ide të veçanta kreative;
 - Rekreative, të cilat me formën, përmbajtjen, frymën dhe mënyrën e realizimit të tyre paraqesin atraktivitet:
-
- Konsolidimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i organizatave rinore;
 - Fuqizimi i Qendrës Rinore dhe Këshillit të Veprimit Rinor Lokal;
 - Promovuese, të cilat kanë për qëllim paraqitjen dhe integrimin e të rinjëve;
 - Stimuluese, të cilat kanë për qëllim evidentimin e talentëve të rinjë me ide të veçanta kreative;
 - Zhvillimi i vullnetarizmit
 - Inovative, të cilat me formën, përmbajtjen, frymën dhe mënyrën e realizimit të tyre paraqesin risi për ambientin krijues;
 - Promovimi i aktiviteteve rinore dhe ndikimi i tyre në mjedis dhe shoqëri.
 - Profesionale, të cilat me kualitetine tyre formal dhe përmbajtësor i respektojnë standardet krijuese vendore dhe ndërkombëtare;
 - Promovuese, të cilat kanë për qëllim paraqitjen dhe integrimin e artistëve vendor në skenën vendore dhe ndërkombëtare;
 - Stimuluese, të cilat kanë për qëllim evidentimin e talentëve në fushën e artit dhe kulturës me ide të veçanta kreative;
 - Tradicionale, perms të cilave do të promovohen vlerat në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;
 - Kritike, të cilat me formën dhe përmbajtjen e tyre nxisin debat dhe diversitet në fushën e kulturës.

1.3 VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTALI I THIRRJES

1. Për financimin e projekteve sipas kësaj Thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion prej; 100,000.00euro.
2. Shuma minimale e financimit për OJQ-të që mund të alokohet për çdo projekt është 500.00 euro ndërsa shuma maksimale 10,000.00 Euro
3. Projektet mund të financohen në shumën e pjesërishme të totalit të kostove të pranueshme të projektit.

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1.Kush mund të aplikoj?

Organizatave jo Qeveritare të regjistruara në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit të Organizatave Jo-Qeveritare, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e sportit. Periudha e zbatimit të projektit është më së largu deri me 31.12.2025.

2.2. Shpenzimet e të pranueshme që do të pranohen përmes kësaj thirrje

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

3. SI TË APLIKONI?

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare

<https://vushtrri.rks-gov.net/>

Dokumentet e kompletuara të futura në zarf të mbyllur duhet të dorëzohet personalisht, duke specifikuar mbi zarf Sektori i Sportit, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Vushtrrisë

Rr.”Adem Jashari”

(zyra e pranimi)

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë nga dita e publikimit të Thirrjes publike, përfundon me 26.03.2025

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin *"Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues"*

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. *Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (e shtypur); (F9)*
2. *Formulari i Propozim buxhetit (e shtypur);(F10)*
3. *Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (e shtypur);(F11)*
4. *Dokumentacionet e OJQ-së:*
 - 4.1 *Certifikata e regjistrimit.*
 - 4.2 *Certifikata e numrit fiskal.*
 - 4.3 *Dëshmia mbi llogarinë bankare (e shtypur).*
 - 4.4 *Vërtetimi mbikryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore.*
5. *Certifikata që nuk është nën hetime për menaxherin e projektit*
 - 5.1. *Certifikata që nuk është nën hetime përfaqësuesi i autorizuar i organizatës*

3.1. Forma përshkruese projekt-propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë. Nëse forma përshkruese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit

Formulari i propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

3.3 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: izet.miftari@rks-gov.net jo më vonë se 8 ditë para skadimit të thirrjes.

Përgjigjet ndaj kërkesave të veçanta do të dërgohet direkt në adresën e pyetjeve të shtruara, dhe përgjigjet më të shpeshta do të publikohen në faqen e mëposhtme të internetit: <https://vushtrri.rks-gov.net/>, dhe jo më vonë se 5 ditë para skadimit të thirrjes.

Për të siguruar trajtim të barabartë të gjithë aplikantëve të mundshëm, një ofrues i mbështetjes financiare publike nuk mund të japë një mendim paraprak për pranueshmerinë e aplikantëve, partnerët, veprimet apo shpenzimet e përmendura në kërkesë.

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 Ofruesi i mbështetjes financiare do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjitha aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kriteret dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

5. KALENDARI I REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE

Fazat e procedurës së thirrjes

1. Afati i fundit për aplikim: 26.03.2025
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen publike: 14.03.2025
3. Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi i aplikantëve: 23.05.2025.

6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

Formularët që mund ti gjeni në web-faqe: <https://vushttri.rks-gov.net/>

1. Udhëzimi për aplikantët (Formulari 4);
2. Formulari i aplikacionit për projekt për OJQ (Formulari 9);
3. Formulari i propozim-buxhetit për OJQ (Formulari 10);
4. Formulari mbi financimin e dyfishtë (Formulari 11);
5. Forma e deklaratës të projekteve të financuara (Formulari 13);
6. Formulari i raportit përshkrues narrative të projektit (Formulari 17);
7. Formulari i raportit financiar të projektit (Formulari 18).